



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA
DHE TË KONFISKUARA

Raporti i aktivitetit për Vitin 2019

Tabela e Përmbajtjes

1. Baza ligjore, ndryshimet e reflektuara në bazë të ligjin 70/2017 dhe puna për permiresimet ligjore në funksion të regjimit të sekuestrimit dhe funksionimit të AAPSK-së.
2. Proceset gjyqësore dhe Vendimet e Gjykatave për vitin 2019.
3. Mbi takimet e Komitetit Këshillimor Ndërinstitucional të Ekspertëve për Masat Kundër Krimit të Organizuar.
4. Informacion mbi pasuritë e sekuestruara, konfiskuara dhe revokuara për 9-mujorin e parë të vitit 2019, nën administrimin e A.A.P.S.K-së.
5. Efektiviteti i përdorimit të pasurive të paluajtshme të dhëna me qira dhe investimin e llogarive bankare.
6. Të ardhurat dhe shpenzimet.
7. Mbi realizimin e prokurimeve për vitin 2019.
8. Funksionimi administrativ i AAPSK.
9. Disa elemente të performancës së AAPSK-së.
10. Problemet specifike me të cilat jemi ndeshur dhe kërkojnë zgjidhje.

Agjencia ka për objekt të veprimitarisë:

- 1- Administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara me vendim të gjykatës, në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafiqeve nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ndryshuar me ligjin 70, dt. 27.4.2017 dhe ligjit te ri nr.34, dt 4.07.2019”Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”*
- 2- Administrimin e pasurive të bllokuara dhe të sekuestruara, në zbatim të ligjit nr. Nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit.”*
- 3- Administrimin e pasurive të tjera të sekuestruara e të konfiskuara, të cilat janë produkt i veprave penale apo të lidhura me to, administrimi i të cilave i caktohet kësaj Agjencie me ligj, me vendim gjykate apo urdhër të Ministrit të Financave.*

1- Baza ligjore, ndryshimet e reflektuara në bazë të ligjin 70/2017; 34/2019 dhe puna për përmirësimet ligjore në funksion të regjimit të sekuestrimit dhe funksionimit të AAPSK-së.

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara është ngritur në zbatim të normave të parashikuara në ligjin nr. 9284, datë 30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”. Në vitin 2009, u miratua **ligji nr. 10192, dt. 3.12.2009** “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ndryshuar me ligjin **70/2017, dt. 27.4.2017**.

Në ndryshimet me themelore që çuan në përmirësimin e ligjit 10192/2009, mund të përmendim:

1. Dorëzimi i pasurive do të realizohet në përputhje të plotë me Kodin e Procedurës Penale nga ana e prokurorit dhe ekzekutimi i vendimit të sekuestrimit apo konfiskimit, nga ana e Oficerit të Policisë Gjyqësore pranë tij. Kjo shmang vonesat e një hallkë problematike si ajo e përmbaruesit, evidenton me mire dhe sakte pasurinë dhe njeh organin e akuzës me gjendjen e saj në momentin e marrjes në administrim.
2. Heq detyrimet e mëparshme që mund të ketë pasur pasuria, për të mos e ngarkuar atë me këto detyrime.

Në muajin korik të këtij viti doli ligji i ri me **nr. 34, date 4.07.2019** “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”. Në zbatim të kërkesave të tij u përgatitën projekt VKM-të nga ana e AAPSK-së dhe konkretisht”:

1. “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, të mënyrave dhe të procedurave të dhënies në përdorim e të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara, në zbatim të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, i ndryshuar dhe nr.34, date 4.07.2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”.
2. “Për kufijtë pagave apo shpërblimit të personelit të jashtëm të kontraktuar nga aapsk-ja”.

3. “Rregullat për përmbajtjen, formën e regjistrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, si dhe për përcaktimin e organeve publike apo subjekteve, që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij”.

Këto projekte së bashku me relacionet përkatëse ndodhen në drejtorinë juridike të MFE. Me miratimin e tyre është bërë gati edhe projektet urdhëri i kryeministrit dhe udhëzimi i MFE, në përputhje me kërkeat e ligjit të ri.

Me miratimin e projektve VKM-ve dhe akteve të tjera normative në zbatim të ligjit nr. 34, datë 4.07.2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, VKM-të me nr.687, 632 dhe udhëzimi i ministrit të Financave dhe Ekonomisë do të shfuqizohen.

VKM nr. 687, dt. 05.10.2011, “Për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara si dhe mënyrë e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”. Me ligjin e ri nr. 34, datë 4.07.2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” ky VKM është shfuqizuar.

VKM nr. 632, dt. 23.07.2010 “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, të mënyrave dhe të procedurave të dhënies në përdorim e të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara, në zbatim të ligjit nr. 10192, dt. 3.12.2009”.

Me Urdhrin e brendshëm nr. 192, datë 25.01.2011 të Kryeadministratorit është miratuar rregullorja “Për administrimin e dokumentacionit zyrtar të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”.

Me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 19, dt. 14.02.2011 është miratuar rregullorja “Për organizimin e punës në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”. Në këtë rregullore përcaktohen qartë detyrat dhe përgjegjësitë e të gjithë punonjësve të Agjencisë.

Më 01.06.2011 është miratuar Kodi i Etikës i Agjencisë, në të cilin përcaktohen rregullat e etikës që duhet t’u përmbahen të gjithë punonjësit e AAPSK.

Në datë 23.02.2018 ka dale urdhri i Ministrit të Financave nr. 71 “Për shitjen e pasurive të konfiskuara në kuadër të masave kundër krimit të organizuar”. Në këtë urdhër përfshihen 13 pasuri të paluajtshme.

Në datë 11.04.2018 kane dale urdhrat e Ministrit të Financave nr. 116, 117,118,119 dhe konkretisht : “Për ngritjen e grupit të punës për kalimin për shitje të pronës së shtetasës Liljana Muca” ; “Për ngritjen e grupit të punës për kalimin për skrap të pasjeve të shoqërisë “Laguna e Karavastasë” ;“Për ngritjen e grupit të punës për nxjerrjen jashtë përdorimit të pasurive të luajtshme në magazinën e AAPSK” ; “Për ngritjen e grupit të punës për kalimin për shitje të pronës së shtetasit Pali Dedja”.

2-Proceset gjyqësore dhe Vendimet e gjykatave për vitin 2019.

Në tabelën e mëposhtme jepen vendimet gjyqësore për vitin 2019

Nr.	Nr.prot & data e dërguesit		Institucioni	Numri dhe data e vendimit	Subjekti	Pasurite sipas statusit		
	Nr.	Data				Sekues.	Konfis.	Revok.
1	137	22.01.2019	Gj.Sh P..K.R	1/09.01.2019	Luan Spahiu			58
2	308	22.2.2019	Gj.A.K.R.	19/21.01.2019	Osman Demirxhiu		1	
3	914	18.03.2019	“ ”	24/29.01.2019	Fatmir Kajolli		4	23
4	2172	12.03.2019	Gj.Sh P..K.R	3/08.03.2019	Lako Levani	3		
5	578	11.03.2019	Gj.Sh P..K.R	17/09.08.2018	Shkelqim Miri	3		
6	383	26.04.2019	“ ”	5/25.03.2019	Admir Murataj	16		
7	602	25.06.2019	“ ”	6/21.06.2019	K.Cani,E.Lika,A. Mullaym., E.Vladi A.e O.Vladi, A.Dervishi	6		
8	684	22.7.2019	“ ”	7/18.07.2019	Valentin Vasil,Leze e Aleks Selaj	16		
9	888	27.9.2019	“ ”	13/26.09.2019	J. Kastrati, Eri e Defrim Elbasani, Astrit Beqiri etj	16		
10	960	10.10.2019	“ ”	8/22.09.2019	Florenc,Bledar Agim Guri	4		
11	959	10.10.2019	“ ”	9/22.09.2019	Adriatik, Lindita Memia	6		
12	961	09.10.2019	“ ”	10/22.09.2019	Altin,Sokol e Flora Koleci	5		
13	962	10.10.2019	“ ”	11/22.09.2019	Ded,Luk,Drane,Illir,Mirush dhe Mentor Pjetri.	12		
14	1055	28.10.2019	Gj.Rr. Fier	1522/20.10.2019	Arjan dhe Lindita Shanaj	5		

3- Mbi takimet e Komitetit Këshillimor Ndërinstitucional të Ekspertëve për Masat Kundër Krimit të Organizuar, urdhrat e Ministrit të Financave dhe informacion mbi ndjekjen e tematikave që kanë dalë gjatë kësaj periudhe.

Në mbledhjen e radhës në fund të vitit të kaluar ju rekomandua Ministrit të Financave dhe Ekonomise ndarja e fondit të krijuar nga pasurite e konfiskuara. Me urdherin e Ministrit të Financave dhe Ekonomise me nr.178, dt 14.05.2019 “Mbi menyren e perdorimit te pasurive Vlera Monetare te konfiskuara” fondi I krijuar nga konfiskimi prej 229,265,876.0 lekë u nda në :

A. 70 milion lekë te derdhen në buxhet.

B. 61.4 milion lekë për AAPSK-në.

C. Pjesa tjetër prej rreth 97.8 milion leke te mbetet si fond i veçante në përputhje me projektet e propozuar nga institucionet.

Deri tani janë derdhur fondet për AAPSK-në dhe në buxhet. Pritej mbledhja e komitetit për të rekomanduar ndarjen e fondit të vecantë, në përputhje me pikën 3 të urdherit të ministrit. Meqënëse mbledhjet e radhës së komitetit për vitin 2019, nuk u zhvilluan për arsye kuorumi, materialet e planifikuara priten të trajtohen në mbledhjen e radhës.

4- Informacion mbi pasuritë e sekuestruara, konfiskuara dhe revokuara për vitin 2019, nën administrimin e A.A.P.S.K-së.

4.1 Pasuri të sekuestruara sipas ligjit kundër financimit të terrorizmit Nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”

Për vitin 2019 nuk ka pasuri të sekuestruara apo konfiskuara, në bazë të ligjit kundër financimit të terrorizmit Nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.

4.2 Pasuritë në administrim sipas llojit dhe statusit të tyre.

Pasuritë në administrim sipas llojit dhe statusit të tyre në fund të vitit 2018 paraqiten në tabelat e mëposhtme.

Tabela 4.2 Pasuritë në datë 31.12.2018

Pasuri të sekuestruara nën administrim					Pasuri të Konfiskuara nën administrim			
Lloji	Pasuri të paluajtshme	Llogari bankare	Makineri & Paisje	Biznese	Pasuri të paluajtshme	Llogari bankare	Makineri & Paisje	Biznese
Nr.	109	93	2	9	43	7	16	-
Në lekë	566,289,298.15	123,124,527.94	--	-	440,298,582	241,253,576.38	6,385,000	
Llogari bankare të revokuara pa dorëzuar Në lekë								
Nr	22	Vlerë	10,368,379.39					

4.3 Pasuritë e marra në administrim gjatë vitit 2019.

4.3.1 Gjate kësaj periudhe janë sekuestruar 41 pasuri si vijon:

- 4 apartamente me vlere të përafërt 24,124,3100.0 lekë.
- 7 truaj dhe toka bujqesore me vlerë të përafërt 11,712,717.0 lekë
- 1 ndertesa me vlerë të përafërt 22,190,000.0 lekë
- 9 llogari bankare në shumen e 50,452,008.0 lekë.
- 4 garazhe me vlerë të përafërt 2,742,700.0 lekë
- 11 automjete me vlerë të përafërt 12,454,950 .0 lekë.
- 5 biznese nga te cilët 3 të vlerësuar me vlerë të përafërt 92,649,633.0 leke dhe 2 pa aktivitet dhe pa asete.

4.3.2 Gjate kësaj periudhe janë konfiskuar 5 pasuri si vijon:

- 1 tokë pyll me sip. 364.000 m² me vlerë të përafërt 45,500,000.0 lekë
- 3 asetet e shoqerive ABA 2011, Parking International dhe Citadela.
- 1 automjet toyota me vlerë të përafërt 2,500,000.0 lekë

4.3.3 Gjate kësaj periudhe janë revokuar 77 pasuri si vijon:

- 6 truaj me vlerë të përafërt 39,814,950.0 lekë
- 25 toke arë, pyll dhe tokë pa fru\at me vlerë të përafërt 238,783,530.0 lekë
- 34 llogari bankare me vlerë të përafërt 2,822,669.31 lekë
- 1 njesi tregëtare me vlerë të përafërt 14,962,500.0 lekë.
- 2 magazina me vlerë 31,791,644.5 lekë
- 2 apartamente me vlere 6,658,400.0 lekë
- 3 automjete me vlerë të përafërt 2,205,000.0 lekë
- 4 shoqeri

Në mënyre të përmblendhur pasuritë e sekuestruara, konfiskuara dhe revokuara gjatë këtij viti, sipas llojit të pasurive jepen në tabelën e mëposhtme :

Sipas statusit të pasurisë	Sipas llojit të pasurive në lekë												
	Apartamente		Truall dhe toka bujqësore		Ndërtesa & njësi tregëtare		Garazhe		Llogari bankare		Auto.		Biz.
	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë	Nr.
Sek.	4	24,124,310	7	11,712,717.0	1	22,190,000	4	2,742,700	9	50,452,008	11	12,454,950	5 Vlera 92,649,633
Konf.			1	45,500,000.0							3 1	Asete 2,500,000	
Revo.	2	6,658,400	31	278,598,480	3	46,754,144	-	--	34	2,822,669	3	2,205,000	4

Në tabelën e mëposhtme jepet inventari i pasurive në dt.31.12.2019.

Nr.rend.	Pasuritë sipas statusit	Numri i pasurive	Vlera në lekë
1	Pasuri të sekuestruara	184	3,129,633,470.85
2	Pasuri të konfiskuara	57	471,502,182.0
Llogari bankare të revokuara pa dorëzuar			
Nr	22	Vlera në lekë	10,368,379.39

5- Efektiviteti i përdorimit të pasurive lidhur me dhënien me qira apo investimin e llogarive bankare.

5.1 Në Tabelen 7. jepen objektet e dhëna me qira sipas muajve, pasurive dhe subjekteve që i kanë marrë me qira pasuritë. Sikundër shihet edhe nga Tabela 7, totali i të ardhurave nga qiratë është **7,672,650 leke**.

Ndonëse të gjitha pasuritë e sekuestruara dhe konfiskuara janë publikuar për dhënie me qira kërkesat kanë qënë shumë të pakta dhe për një serë prej tyre nuk ka fare interes.

5.2 Llogaritë bankare të sekuestruara kanë qënë në formën e llogarive rrjedhëse, depozitave apo të investuara në bono thesari. Në çdo rast është ndjekur një politikë e qartë e investimit të këtyre pasurive.

6-Të ardhurat dhe shpenzimet

6.1 Bilanci i të ardhurave dhe shpenzimeve.

Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2019, në mënyrë të përmbledhur jepet në tabelën e mëposhtme:

Të ardhura në lekë	Shpenzime në lekë	Bilanci
69,102,226,42	34,701,320.95	+34,400,905.47

6.1.1 Tabela e të ardhurave sipas burimit të krijimit

	Emërtimi	Vlera në lekë	Vlera në %
1	Qiraja e objekteve	7,655,833	11.1%
2	Të ardhurat nga interesat	24,627	0.03%
3	Te ardhura nga konfiskimi i pasurise	61,400,000	88.8%
4	Te ardhura nga kamat vonesa per pasurite e dhena me qera	21,772	0.03%
	Të ardhura gjithsej	69,102.226	100%

Sikundër shihet edhe nga tabela, zërin kryesor të të ardhurave e zënë të ardhurat e krijuara nga pasuritë e konfiskuara në shumën **61,400,000 lekë** ose **88.8% të totalit të ardhurave** .

Pjesa tjetër e të ardhurave prej 7,655,883 lekë ose 11.1% të totalit të ardhurave, vjen nga të ardhurat e pasurive të dhëna me qira dhe 24,627 lekë ose 0.03%, vjen nga të ardhurat nga interesat e depozitave bankare për pasuritë e sekuestruara dhe konfiskuara, të investuara nga AAPSK-ja, deri në momentin e vendimit përfundimtar të gjykatës. Këto interesa reflektohen me së shumti, nga afatet e maturimit të mjeteve monetare dhe kohën e përfitimit të interesave që korrespondon me periudha të tjera të vitit. Në zbatim të kontratave të qerasë së lidhur me qeramarrësin, mbështetur në kushtet e vendosura në kontratat e qerave, gjatë vitit 2019, janë vjelur edhe 21,772 lekë kamatë vonesa, për pagesat e qerave jashtë afatit të përcaktuar në kontratë, kjo edhe në zbatim të detyrave të lëna nga rekomandimet e Auditit të Brëndshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe KLSH-së.

Gjatë vitit 2020, më Urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.178, datë 14.05.2019, nga pasuritë e konfiskuara, kanë kaluar në buxhetin e shtetit 70,065,786 lekë, në fondin e vecantë 93,403,412 lekë, për tu përdorur dhe ndarë për projekte që do të propozohen nga institucione ligjzbatuese dhe OJQ-të dhe 61,400,000 lekë kanë kaluar si të ardhura për AAPSK-në, për ushtrimin e veprimtarisë. Të ardhurat e sipërcituara, kanë ardhur si rezultat i konfiskimit me vendime gjykatë të depozitave dhe llogarive në lekë dhe valutë.

Gjatë vitit 2018, nga AAPSK-ja janë dhënë me qera 37 objekte dhe të ardhurat nga qeratë kanë qënë 5,048,808 lekë, ndërsa në vitin 2019, janë dhënë me qera 40 objekte dhe të ardhurat nga qeratë janë 7,672,650 lekë , **nje rritje prej 2,623,842 lekë ose me një rritje 52% në krahasim me vitin 2018.**

Në tabelën e mëposhtme jepen shpenzimet analitike sipas llojit të kryerjes së tyre. Shpenzimet janë ndarë sipas llojit dhe ndarja e tyre është bërë në lidhje me natyrën e shpenzimit në përputhje me miradministrimin e pronës.

6.1.2Tabela e shpenzimeve analitike.

Nr.	Emërtimi	Vlera në lekë	Vlera në %
1	Shërbimi i rojes se objekteve te sek/konf.	18,260,734	52.6%
2	Sigurim i domosdoshëm	275,700	0.8%
3	Naftë	332,150.40	0.95%
4	Dieta	1,662,555	4.8%
5	Kancelari	149,546	0.43%
6	Shpenzime mirëmbajtje	0	0
7	Ujë + energji	63,637.45	0.18%
8	Taksa vendore	756,676.20	2.18%

9	Tatimi ne burim për pronat e dhëna me qira	293,760	0.83%
10	Pagat + Sigurime shoqerore	12,402,911	35.7%
11	Kthim garanci kontrate	30,000	0.08%
12	Komisione bankare	7,250	0.02%
13	Pagese qeraje per magazine	466,400	1.34%
13	Shuma e shpenzimeve	34,701,320.95	100%

Nga tabela shihet qartë, se zërin kryesor të shpënzimeve, e zënë shpënzimet për ruajtjen e objekteve të sekuestruara apo të konfiskuara, në shumën prej 18,260,734 lekë ose 52.6% të totalit të shpënzimeve.

Mbështetur në VKM nr. 687, datë 5.10.2011, kapitulli i 7-të, “Të ardhurat dhe shpënzimet për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” pika ç, “Shpënzimet për shërbimet e ruajtjes dhe të sigurisë fizike”, AAPSK-ja ka marrë masat për ruajtjen fizike të objekteve të sekuestruara dhe konfiskuara të marra në administrim. AAPSK-ja ka qenë e detyruar të ruajë fizikisht disa pasuri të sekuestruara/konfiskuara, të cilat për shumë arsye ,nuk mund të jipen me qera në mënyrë që të krijojnë të ardhura, përkundrazi ato vetëm rrisin shpënzimet e ruajtjes së objekteve.

Në këtë kuadër AAPSK-ja ka shpallur për dhënien me qera të gjitha pasuritë e paluajtëshme të sekuestruara/konfiskuara, por jo për të gjitha objektet ka patur interes. Kjo lidhet me faktin e vendodhjes së pronës, problemit në lidhje me pronarin e pronës (Probleme me Ligjin) me mundësinë e kufizuar për të bërë investime në pasurinë e marrë me qira nga qiramarrësi, me afatin e përdorimit të pronës me qera, apo prona të sekuestruara me vendim Gjykatë me pronësi të pjesëshme. Për këtë arsye AAPSK-ja detyrohet të vendosë në objekte shërbimin e ruajtjes së objekteve deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës.

Zërin e dytë kryesor të shpënzimeve e zënë pagat + sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në shumën prej 12,402,911 lekë ose me 35.7% të totalit të shpënzimeve .

Gjatë vitit 2019, kemi zero shpënzime për mirëmbajtje pasurie, zero shpënzime për pagesë eksperti për vlerësim pasurie/ekspert kontabel. Gjate kësaj periudhe është bërë dhe sigurimi i pasurive të paluajtëshme pranë kompanive të sigurimeve konform ligjeve dhe vëndimeve në fuqi.

Gjatë vitit 2019, është paguar në kohë tatimi në burim, i krijuar mbi të ardhurat nga pasuritë e dhëna me qera. Agjencia e Administrimit të Pronave të Sekuestruara dhe Konfiskuara ka kryer edhe disa shpënzime te tjera si: shpënzime për pagesen e detyrimeve të prapambetura për taksat

vendore për Bashkinë Tiranë, për pagesë për uje + energji elektrike, për objekte të konfiskuara të cilat i janë dhënë në përdorim Shoqërisë Civile “Patners Albania”, për zhvillimin e projekteve të ndryshme, në funksion të trajtimit të viktimave të trafikimit.

7-Mbi realizimin e Prokurimeve Publike për vitin 2019

Mbështetur në nenin 29, pika 5, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 40, pika 3, Kreu IV të Vëndimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë. 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” AAPSK-ja për fondet e planifikuara për vitin 2019, ka kryer procedurat e Prokurimit Publik kryesisht me Procedurë me “Blerje të vogla”, nga njësia e Prokurimit e ngritur me Urdhër të Titullarit të Institucionit nr 7, datë 7.01.2019

Për e vitin 2019, janë lëshuar nga Kryeadministratori i AAPSK-së gjithsej 7(shtatë) Urdhëra Prokurimi me “Blerje të Vogla” dhe 7 (shtate) procedura prokurimi janë zhvilluar me si më poshtë vijon:

- Urdhër Prokurimi “Blerje kancelarie”, me fond limit 99,016 leke pa tvsh dhe realizim me vlerë 78,000 lekë pa tvsh.
- Urdhër Prokurimi “Blerje kancelarie”, me fond limit 146,568 leke pa tvsh dhe realizim me vlerë 103,200 lekë pa tvsh.
- Urdhër Prokurimi “Blerje shërbim riparim autoveture”, me fond limit 292,200 leke pa tvsh dhe realizim me vlerë 199,000 lekë pa tvsh.
- Urdhër Prokurimi “Blerje sigurim i domosdoshem pasurie”, me fond limit 10,700 leke pa tvsh dhe realizim me vlerë 10,200 lekë pa tvsh.
- Urdhër Prokurimi “Blerje sigurim i domosdoshem pasurie”, me fond limit 209,000 leke pa tvsh dhe realizim me vlerë 208,000 lekë pa tvsh
- Urdhër Prokurimi “Blerje sigurim i domosdoshem pasurie”, me fond limit 57,658 leke pa tvsh dhe realizim me vlerë 57,000 lekë pa tvsh
- Urdhër Prokurimi “Blerje shërbim riparim autoveture”, me fond limit 162,400 leke pa tvsh dhe realizim me vlerë 160,000 lekë pa tvsh.

Mbështetur në Rregjistrin e parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2019, AAPSK-ja ka kryer edhe katër procedura prokurimi me blerje të vogla nën vlerën 100,000 lekë pa Tvsh.

- “Blerje shërbimi karrotreci”, me fond limit 13,333 lekë pa tvsh dhe realizuar 13,333 lekë pa tvsh, procedurë e realizuar me formular urgjence procedurë e paraparë në legjislacionin në fuqi.
- “Blerje shërbimi karrotreci”, me fond limit 80,000 lekë pa tvsh dhe realizuar 80,000 lekë pa tvsh, procedurë prokurimi me blerje të vogla nën vlerën 100,000 lekë pa Tvsh

- “Shërbim i ruajtjes së ambjenteve të zyrave të AAPSK-së me sisteme alarmi”, me fond limit 77,000 lekë pa tvsh dhe realizim me vlerë 77,000 lekë pa tvsh. procedurë prokurimi me blerje të vogla nën vlerën 100,000 lekë pa Tvsh
- “Blerje materiale pastrimi për zyrat” me fond limit 69,860 leke pa tvsh dhe realizim me vlerë 69,860 lekë pa tvsh. procedurë prokurimi me blerje të vogla nën vlerën 100,000 lekë pa Tvsh
- “Blerje shërbimi mirëmbatje ndertese, zyra” me fond limit 48,792 lekë pa tvsh dhe realizim 48,792 lekë pa tvsh.
- “Blerje shërbimi mirëmbatje ndertese, zyra” me fond limit 33,500 lekë pa tvsh dhe realizim 33,500 lekë pa tvsh. procedurë prokurimi me blerje të vogla nën vlerën 100,000 lekë pa Tvsh
- “Blerje shërbimi përkthim Legjislacioni” me fond limit 23,400 lekë pa tvsh dhe realizim 23,400 lekë pa tvsh. procedurë prokurimi me blerje të vogla nën vlerën 100,000 lekë pa Tvsh

Në vitin 2019 AAPSK-ja, nuk kishte të planifikuar në buxhet fond investimesh. Bashkelidhur roportit gjendet pasqyra e realizimit të prokurimeve me blerje të vogla për vitin 2019, Tabela 8.

8-Funksionimi administrativ i AAPSK-së.

Gjatë këtij viti, Sektori Administrativ ka vijuar punën për mbarëvajtjen e aktivitetit të përditshëm të Agjencisë, si për sa i përket shërbimeve mbështetëse, ashtu edhe për burimet njerëzore.

Është kryer inventarizimi i aseteve dhe materialeve në përdorim të punonjësve të Agjencisë. Është bere inventarizimi i gjendjes në dy magazinat (atë të Agjencisë dhe magazinën e administratoreve). Janë mbajtur proces verbalet përkatëse ku janë kryer edhe vlerësimet për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve të dëmtuara të prishura apo jashtë funksionit.

Është realizuar procedura e nxjerrjes jashtë përdorimi dhe asgjësimi i inventarit të imët dhe aseteve jashtë funksioni. Janë hartuar pasqyrat financiare dhe është kryer mbyllja e bilancit vjetor të aktivitetit buxhetor të Agjencisë për vitin 2018, si dhe dorëzimi i tij në kohë, pranë degës së Thesarit Tiranë.

Është hartuar Regjistri i parashikimeve të prokurimeve dhe dërguar në APP brenda afatit.

Është vijuar me ndjekjen e procedurave të Prokurimeve Publike të programuara, si dhe është kryer pagesa në kohë e të gjitha detyrimeve.

Gjithashtu, janë kryer rakordime të herëpashershme me Degën e Thesarit për sa i përket Urdhër shpenzimeve.

Administratorët e pasurive për gjatë kësaj periudhe kanë vijuar të jenë **9** (nëntë) persona.

Sa i përket aktiviteteve në vijim të projekteve të bashkëpunimit të financuara nga BE, përfaqësues të AAPSK-së kanë marrë pjesë në:

- Në muajin mars punonjësit e AAPSK-se, moren pjesë në seminarin e organizuar nga BE mbi startegjinë e luftës kunder krimit të organizuar dhe ndërtimin e një plani kalendar për bashkërendimin e punës në të ardhmen, në perputhje me plotësimin e kerkesave të “Moneyval-it”.
- Gjatë vitit 2019 përfaqësues të AAPSK-se kanë marrë pjesë në të gjitha takimet e organizuar nga kordinatoret institucionale me përberjen e përfaqësuesve të institucioneve që marrin pjesë në luftën kunder krimit të organizuar, për përparimin e legjislacionit me atë të BE.
- Në muajin qershor në Napoli ku mori pjesë dhe Kryebashkiaku i Napolit, u zhvillua konferenca si pjesë e një diskutimi në Universitetin e Napolit ‘Federiko 2’, Departamenti i Shkencave Politike për menaxhimin e aseteve të konfiskuara nga krimi i organizuar. Një shans i madh për të ndarë përvojën tonë në këtë fushë përmes projektit CAUSE të zbatuar në partneritet me Partners Albania dhe projektin Perpara, Comitato don Peppe Diana. Kjo konferencë ishte pjesë e një vizite katër ditore në Napoli dhe takimeve intensive me zyrtarë publik dhe ndërmarrjet aktuale sociale që veprojnë në pronat e konfiskuara. Një mesazh i fortë nga të dy vendet, Shqipëria dhe Italia, në përpjekjet e tyre të përbashkëta për të luftuar krimin e organizuar.
- Këtë vit u realizua edhe projekti i dytë në Durrës, “**Kink Folk Coffe Library**”. Ndërsa është përfunduar dhe projekti i tretë në Sarandë, “**Garazh Social Punime Artizanale**” i cili ka vazhduar të funksionojë por do inagurohet në fillim të këtij viti.
- Me inisiativën e Ministres së Drejtësisë Etilda Gjonaj dhe Ministres së Financave dhe Ekonomisë Anila Denaj me datë 15 Nëntor u realizua konferenca, “**Administrimi, Menaxhimi dhe Përdorimi i Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara: praktikat me të mira dhe aspekte të bashkëpunimit ndërkombëtar**”, ku morën pjesë drejtues të lartë të institucioneve ligjzbatuese Italiane si: Prokurori Kombëtar të Drejtorisë Antimafia dhe Antiterrorizem Federico Cafiero De Raho, drejtori i Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Bruno Frattasi si dhe ambasadorët Soreca i BE dhe Cutillo i Italisë.

Vlen të theksohet, vendosja e programit të sistemit të informatizimit të të dhënave. Firma fituese e projektit realizues e përzgjedhur nga AKSH-i ka instaluar programin në AAPSK, ka kryer trajnime për administratorët dhe punonjësit e AAPSK-së dhe është në monitorim të procesit, për zgjidhjen e problemeve që janë shfaqur gjatë hedhjes së të dhënave dhe përpunimit të tyre. Ka përfunduar hedhja e të dhënave dhe po punohet për nxjerrjen e treguesve përgjithësues të aktivitetit të AAPSK.

9- Disa elemente themelore të performancës së AAPSK.

Në përputhje me kërkesën themelore të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikeve nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ndryshuar me ligjin 70, dt. 27.4.2017, për miradministrimin e pasurisë dhe detyrave që rrjedhin prej tij, nga ligji i ri nr.34, date 4.07.2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, efikasiteti i punës së AAPSK-se do të performohej në disa elemente thelbësore dhe konkretisht:

1. **Në tremujorin e tretë të vitit 2019, me daljen e ligjit të ri nr. 34, date 4.07.2019** “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, në zbatim të kërkesave të tij u përgatitën projekt VKM-të nga ana e AAPSK-së dhe konkretisht:

- “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, të mënyrave dhe të procedurave të dhënies në përdorim e të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara, në zbatim të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, i ndryshuar dhe nr.34, date 4.07.2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”.
- “Për kufijtë pagave apo shpërblimit të personelit të jashtëm të kontraktuar nga aapsk-ja”.
- “Rregullat për përmbajtjen, formën e regjistrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, si dhe për përcaktimin e organeve publike apo subjekteve, që kanë të drejtë qasjen në informacionin e tij”.

Këto projekte së bashku me relacionet përkatëse ndodhen në drejtorinë juridike të MFE. Me miratimin e tyre është bërë gati edhe projektet urdhëri i kryeministrit dhe udhëzimi i MFE, në përputhje me kërkesat e ligjit të ri.

2. **Në kuadër të rekomandimeve të “Moneyval” gjatë vitit 2019 është punuar dhe po punohet**, për riformatimin ligjor të përfshirjes në një institucion të vetëm për rregjimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, në bashkëpunim me drejtorinë Juridike të Ministrisë së Financave dhe në bashkërendim me Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Drejtësisë dhe Prokurorinë e Përgjithëshme

3. **Mbi vendimet e gjykatave të ardhura dhe realizimet e marrjes së pasurive.** *Nuk ka asnjë rast të vetëm që administratori i pasurisë të mos i jetë përgjigjur OPGJ në kohën dhe vendin e kërkuar, për marrjen në dorëzim të pasurisë.* Edhe kur ka pasur vonesa në marrjen në administrim, kjo ka ardhur për efekt të mos koordinimit të OPGJ me institucione të tjera (pushtet lokal, topograf, polici, subjekt).

4. **Komunikimin me prokurorinë, gjyqësorin dhe institucionet e tjera.** *Në çdo rast administratori i pasurisë, që në momentin e mbërritjes së vendimit të gjykatës dhe marrjes së pasurisë, ka njoftuar institucionet mbi realizimin e procesit dhe të marrjes në administrim të saj, me ndryshimet që mund të ketë kjo pasuri. Me ndryshimet e reja në ligjin nr. 70, dt.27.04.2017 (dorëzimi i pasurive të sekuestruara tek administratorët e AAPSK-se bëhet nga Oficerët e Policisë Gjyqësore), ky bashkëpunim është rritur.*

5. *Në rastet e revokimit të pasurive, në asnjë rast nuk jemi penalizuar për mos administrim të mirë të pasurive, qoftë kjo pasuri e paluajtshme apo llogari bankare. Nuk ka asnjë proces gjyqësor për këtë qellim, me pasoja financiare.*
6. **Për një efikasitet në administrimin e pasurive, janë publikuar të gjitha pasuritë e paluajtshme të mundshme, për dhënie me qira, apo është kërkuar interesi më i mirë në treg, për llogaritë e depozituara.**
7. **Kemi bashkepunuar me Partners Albania dhe Delegacionin e BE për implementimin e projektit C.A.U.S.E.** Pas përfundimit dhe suksesit që pati projekti i parë në pronën e konfiskuar pasticëri “Ke Buono” janë shpallur fituesit për dy projekte të tjera “KinFolk Coffe Library” në Durrës dhe “Social Crafting Garage Saranda” në qytetin e Sarandës, pritet të inagurohet në fillim të këtij viti, si pjesë e projektit C.A.U.S.E implementuar nga Partners Albania për ndryshim e zhvillim në bashkëpunim me AAPSK e financuar nga BE me vlerë 350 mijë Euro.

8. **Mbi administrimin e rezortit “Santa Quaranta”.**

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2019 aktiviteti në subjektin turistik “Santa Quaranta Premium Resort” shpik është zhvilluar në disa ambiente të pajisuar me kasat fiskale perkatese, si me poshte:

- Bar hall (Bar Veranda)
- Restorant i cili është mbyllur në datën 23 Tetor për shkak të numrit të ulët të frekuentimeve dhe nga kjo datë ka shërbyer vetëm kuzhina për të përgatitur mëngjesin për klientët e hotelit, Gjithsesi për pasijen fiskale të restorantit nuk është bërë kërkesë për pezullim të perkohshëm, por ka vijuar transmetimi me vlerë zero çdo natë sipas dispozitave tatimore në fuqi.
- Hotel (reception i pajisur me një pajisje fiskale me dy regjime tatimore-tvsh 20 % për minibarin dhe lavanderinë dhe 6% për hotelerinë)
- Fast Food i cili ka filluar aktivitetin për këtë sezon në datë 15.06.2019, i pajisur me dy kasa fiskale me regjim tatimor 20%. Kjo pikë shitjeje ka mbyllur ushtrimin e aktivitetit në datën 30.09.2019.
- Bar Pishina, pikë shitjeje që ka mbyllur aktivitetin për këtë vit në datë 5 Tetor.
- Beach Bar, i cili ka mbyllur aktivitetin në 05.09.2019.
- Restorant Pishat, që ka mbyllur ushtrimin e aktivitetit në datë 1 Shtator 2019.

Numri i ulët i pushuesve është reflektuar edhe në vënien në funksion me vonesë të ambienteve të ushtrimit të aktivitetit si: Bar Pishina, Beach Bar, Restorant Pishat, të cilat hapen dhe ushtrojnë

aktivitet vetem gjate muajve te veres. Bar Pishina ka filluar te ushtroje aktivitet ne date 03 Korrik 2019. Edhe Beach Bar edhe Restorant Pishat kane filluar aktivitetin ne fillim te muajit Korrik duke reflektuar nje xhiro te ulet jo vetem ditet e para por edhe ne vijim. Kushtet jo te favorshme klimaterike ne fund te muajit shtator 2019 diktuan nje numer te ulet turistesh, gje e cila reflektoi drejtperdrejte ne qarkullim te ulet ne hotel edhe ne baret dhe restorantet e resortit.

Te ardhurat per periudhen Janar – Dhjetor 2019 kane qene 195,097,090 leke me tvsh.

TE ARDHURAT	
	VITI 2019
BAR/RESTORANT/PLAZH/PISHINE	107,600,818
TE ARDHURA TE TJERA (marketing, autofature)	1,570,181
HOTELERI	85,926,091
TOTAL	195,097,090

Pergjithesisht viti 2019 perjetoi nje renie te ndjeshme te numrit te pushuesve ne rang vendi dhe ne qytetin e Sarandes ne vecanti. Nisur nga komunikimet me partneret tane ne lidhje me kete numer te ulet te pushuesve qe frekuentojne vendin tone kete vit, shprehen se kjo situatë lidhet drejtperdrejte me situaten e ndere politike qe kane shoqeruar vendin gjate gjysmes se pare te vitit. Protestat e opozites e kane bere vendin te humbas terren ne ranglisten e vendeve te cilat perbejne atraksion per te kaluar pushimet, kryesisht nga turistet e huaj. Trasmetime I protestave nga mediat e huaja ka ndikuar drejtperdrejte ne perzgjedhjen e destinacioneve nga turistet per te kaluar pushimet. Kjo shpjegohet edhe nga numri I madh I anulimeve te akomodimeve te rezervuara kohe me pare (ne fund te vitit 2018, apo ne fillim te vitit 2019). Numri I anulimeve reflekton pikerisht pasigurine e perceptuar nga turistet te cilet kane anuluar planet e tyre per tu akomoduar prane resortit tone, e cila ka reflektuar drejtperdrejte ne uljen e te ardhurave te gejnueruara nga aktiviteti. Vetem ne muajt Maj, Qershor dhe Korrik 2019, numri I neteve te anuluar ne total eshte 3267 nete qendrimi. E perkthyer vetem ne vlere akomodimi, te ardhurat e munguara llogariten ne vleren 313,000 euro ose rreth 38,000,000 leke. Ne mund te llogaritim vetem te ardhurat e munguara nga akomodimi, por nuk duhet lene jashte fokusit te ardhurat e munguara ne bar, restorant apo ne tregetimin e sherbimeve te tjera cka e ben edhe me te madhe koston financiare nga numri i larte i anulimeve. Numrin me te madh te anulimeve e zene grupet e organizuara ne raport me turistet individuale. Ne tipologjine e turistevet per vitin 2019, ka pasur nje renie te numrit te turistevet polak dhe nje rritje te turistevet gjermane te cilet I perkasin kryesisht moshes se trete, nje target grup ky I prirur drejt shpenzimeve te vogla. Per periudhen Janar – Dhjetor 2019 jane paguar paga dhe sigurime ne shumen 41,514,328 leke te reja me nje

numer mesatar punonjesish 59 persona. Jane paguar paga 35,889,409 leke dhe 5,624,919. Per vitin 2019 eshte tentuar te ulet numri I te punesuarve duke rekrutuar personel me te kualifikuar per te siguruar vazhdimesine. Numri maksimal I punonjesve ishte ne muajin Korrik 2019, 166 punonjes. Ne fund te Dhjetorit numri I punonjesve ishte 22 persona.

SHPENZIMET

Gjate periudhes Janar – Dhjetor 2019 jane realizuar shpenzime te pasqyruara nepermjet fatururave tatimore (pasi ka dhe shpenzime si detyrimet ndaj organeve tatimore, qera, blloqe tatimore, etj.) ne shumen 75,946,565 leke me tvsh. Kesaj vlere i shtohen edhe shpenzimet per komisione bankare dhe mirembajtje llogarie, ne vleren 1,277,807 leke. Peshen me te madhe e zene blerjet per mallrat e shitshem ne bar dhe restaurant si dhe lendet e para per guzhinen ne shumen 44,130,244 leke me tvsh. Blerjet per detergjente dhe materiale ndihmese ne hotel dhe bar/restoarnt kane qene ne shumen 4,521,856 leke me tvsh. Gjithashtu edhe shpenzimet per mirembajtje dhe riparime kane qene ne shumen 4,206,154 leke.

Gjate vitit 2019, ka pasur edhe blerje me fatura tatimore per; gaz te lengshem per ngrohje dhe gatim, energji elektrike, inventar I imet dhe AQT (per te zvendesuar ato te amortizuarat)etj. Me hollesisht blerjet (shpenzimet) jane te shpjegura nga tabelën e mëposhtme:

JANAR - DHJETOR 2019		
	Emërtimi	JANAR - DHJETOR 2019
1	Shitjet	
	705 Shitje mallrash (Bar/Restorant)	107,600,818
2	Te ardhura te tjera	
	708 Të ardhura nga shitje te tjera (Hoteleri)	85,926,091
	7080 Të ardhura nga shitje te tjera	1,570,181
	Totali I te ardhurave	195,097,090
3	Materialet e konsumuara	
	6011 Blerje materiale të para (ushqimore, piqe, etj.)	44,130,244
	6012 Blerje materiale të tjera (elektrike dhe hidraulike)	
	6013 Blerje materiale ndihmese (detergjente dhe materiale pastrimi)	4,521,856
	602 Blerje objekte inventari (aq)	6,031,102
	Blerje Objekte inventari (inventar I imet)	3,696,878
	604 Gaz i lengshem	2,233,922
	6040 Naftë per gjeneratorin	178,200
	608 Energji elektrike	7,435,529
	Shuma	68,227,731
a	Paga e personelit	
	641 Pagat dhe shpërblimet e personelit	35,889,409
b	Sigurimet shoqerore e shendetesore	
	644 Sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	5,624,919
	Shuma paga dhe sigurime	41,514,328
4	Shpenzime te tjera	
	611 Trajtime të përgjithshme (sherbime financiare dhe juridike, etj.)	492,000
	6080 Shpenzime per mengjese hotelerie (autofature)	387,000
	615 Mirëmbajtje dhe riparime	4,206,154
	616 Sigurime	647,880
	6270 shpenzime transporti per blerjet	6,480
	624 Publicitet, marketing, INTERNET, TV	569,944
	6280 Komisione booking	705,183
	628 Shpenzime për shërbimet bankare	1,277,807
	618 Te tjera (pagese per te drejten e autorit)	494,189
	Kancelari	210,004
	Shuma shpenzime te tjera	8,996,641
	Totali i shpenzimeve	118,738,700
	Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore	76,358,390
	Fitimi (Humbja) para tatimit	76,358,390
5	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	
	69 Tatimi mbi fitimin	22,614,534
	Fitimi periudhes	53,743,856

Gjate periudhes Janar – Dhjetor 2019 jane kryer edhe pagesat e meposhteme:

- Tatim mbi vleren e shtuar	13,079,478	leke
- Tatim fitimi per vitin 2018 dhe kestet per vitin 2019	22,614,534	leke
- Takse vendore per fjetjen ne hotel	1,583,960	leke
- Takse vendore ndertese per vitin 2018, 2019	1,980,714	leke
- Takse vendore e sherbimit public 2018, 2019	160,000	leke
- Takse plazhi (dy keste) per vitin 2019	1,286,650	leke
- Qera per apartamentet e stafit	200,758	leke
- Tatim ne burim per qerane	30,112	leke
- Tatime te tjera	48,363	leke
- Tarife per aplikimin per leje mjedisore	10,000	leke
- Energji per apartamentet e stafit	86,250	leke
- Blerje blloqe tatimore dhe pagese marketingu (Dertouristik)	58,460	lek

10- Problemet specifike me të cilat jemi ndeshur dhe vazhdojmë të ndeshemi.

Më poshtë po relatojmë shkurtimisht problemet kryesore me të cilat ndeshet AAPSK-ja, të parashtruara edhe në takimet e mëparshme të Komitetit Këshillimor Ndërinstitucional të Ekspertëve për Masat Kundër Krimit të Organizuar dhe konkretisht:

- 1- Mos funksionimi i Gjykatës se Larte te krimeve te renda,** ka sjelle vonesa në trajtimin e shumë çështjeve dhe rrjedhimisht, kane shkaktuar një zvarritje në kohe dhe shpenzime për miradministrimin e tyre.
- 2- Vonesa në marjen në administrim të pasurive nga ana e OPGJ.** Mos dorzimi në kohë nga ana e OPGJ me elementet e plote të specifikuara për pasuritë ka sjelle, që numri i pasurive të pa mara në dorzim të jetë mjaft i lartë.
- 3- Për disa pasuri të luajtshme që ju bie vlera në një kohë të shpejtë,** kemi kërkuar nga prokuroria dhe gjykatat vendimin për shitjen e tyre të menjëhershëm. Deri më sot sugjerimet dhe kërkesat tona nuk janë mare në konsideratë.

11- Prioritetet dhe angazhimet institucionale të AAPSK-së për përmirësimin e punës në të ardhmen.

Në vitin në vazhdim AAPSK ka përcaktuar prioritetet që kërkojnë zgjidhje dhe angazhimin e plotë të saj në përmirësimin e punës. Ky përmirësim motivohet edhe me tepër nëpërmjet dy auditimeve të aktivitetit të AAPSK-se të kryera gjatë periudhës 2016-2017 dhe konkretisht:

1-Raporti i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe planin e masave të lëna për tu realizuar në afat të përcaktuar kohor.

Në përputhje me detyrat e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe të planit të masave për përmbushjen e këtyre detyrave dhe angazhimeve, janë realizuar :

1. Reformulimin e Rregullores së Brendshme,
2. Reformulimin e Kodin të etikës së punonjësit,
3. Administrimin e dokumentacionit zyrtar.
4. Inventarin e plotë të pasurive nën administrim dhe të vet AAPSK-së .
5. Inventarin e vendimeve të gjyqësorit në kronologjinë dhe vazhdimësinë e tyre.
6. Hartimin e regjistrit të riskut.
7. Dalja jashtë përdorimit të materialeve të amortizuara dhe konsumuara, etj.

Në fund të 3-mujorit të parë të këtij viti janë realizuar plotësisht të gjitha rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, brenda afateve të përcaktuara prej tij.

2-Kontrolli i auditit i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë vlerësoj pozitivisht punën 2 vjeçare të bërë nga AAPSK-ja dhe la disa rekomandime për plotësimin e tyre, në afate të përcaktuara dhe konkretisht:

- a. Hartimi dhe miratimi i procedurave për vlerësimin të performancës së punës së administratoreve dhe ndihmës administratoreve. *Eshtë miratuar.*
- b. Ndërtimi i një regjistri të plotë dhe të detajuar për pasuritë e revokuara. *Ky rekomandim është realizuar në muajin gusht 2019.*
- c. Të përcaktoje kriteret dhe limitet e pagave të administratoreve dhe ndihmës administratoreve. *Në funksion të hartimit të projekt udhëzimit në zbatim të ligjit 34/4.07.2019, do të vendosen edhe këto elemente.*

3- Ndërtimi i sistemit të të dhënave dhe implementimi i tij në kompjuterat e AAPSK-së, na jep një mundësi shumë të mirë në informatizimin e të dhënave dhe ndjekjen në çdo hap, të ecurisë së marjes në administrim dhe miradministrimin e pasurive. Ky sistem i të dhënash na mundëson një koordinim më të mirë midis operacioneve konkrete që kryen, kohën në të cilën realizohen ato, bashkërendimin e punës me institucionet bashkëpunuese në këtë proces, informacionin më të plotë në lidhje me ecurinë e procesit të sekuestrimit apo konfiskimit dhe mbi të gjitha, një efikasitet në punën tonë. Ky sistem do të shërbejë edhe si një lidhje pararendëse me institucionet e tjera që marrin pjesë në luftën kundër krimit, për të krijuar një sistem unik të marjes dhe përpunimit të informacionit në kohe, bashkërendim, unifikim dhe vazhdimësi në të gjitha problemet dhe statistikën në këtë fushë. *Sistemi është instaluar në AAPSK dhe administratorët kanë hedhur të*

dhënat nën monitorimin e specialisteve të firmes që ka ndertuar sistemin. Jemi në fazën e nxjerjes së treguesve integralë të aktivitetit të AAPSK-së.

4- Pjesëmarrja aktive ne grupet e punes për përafrimin e legjislacionit tone me ate te BE. AAPSK-ja ka marrë pjesë aktive në 3 grupet e përbashkëta të punës të organizuara dhe bashkërenduara nga MB, MD dhe MPEJ (MONYVAL, Kapitulli 23,24,Strategjine Antikorrupsion) etj. Ne kete konteks nje vend te rendesishem zenë rekomandimet e Moneyval-it.

5-Përmirësimi i marrëdhënieve me institucionet e tjera për sa i përket zbatimit të memorandumeve të ndryshme të bashkëpunimit. Trajnimet dhe takimet e përbashkëta me prokurorë, oficerë gjyqësorë dhe punonjës të krimit ekonomik në MPB, janë të domosdoshme të realizohen periodikisht për rritjen e efikasitetit të punës në luftë kundër krimit të organizuar.